



Projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian

Analizë mbi situatën e tanishme të Sektorit Kulturor në Mitrovicë

Komuna e Mitrovicës

7ARTE

Mars, 2016

Mbështetur nga:



Implementuar nga:



Projekti “Politikat kulturore në fokus të RROK të Mitrovicës” është financuar dhe përkrahur nga CBM dhe CRYM në kuadër të projektit “Shoqëria Civile është duke ju shikuar: Kërkesa për Përgjegjësi dhe Transparencë në Nivel Lokal”, një projekt i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra e Bashkimit Evropian, dhe i bashkë-financuar nga Agjensioni Austriak për Zhvillim, Ambasada Holandeze në Prishtinë, dhe Fondacioni MOTT.

Shënim i Autorit

Ne, formalisht deklarojmë që në këtë projekt hulumtues kemi punuar në mënyrën më zyrtare të mundshme, në përputhshmëri me rregullat dhe rregulloret e stilit APA për hulumtime akademike. Të gjitha të dhënat janë të bazuara në fakte nga burime të ndryshme të përmendura në pjesën e analizës, referencave brenda tekstit dhe pjesës për referenca.

Autorët:

Lulim Hoti – Drejtor i 7Arte

Berna Xhemajli – Kordinatore e projektit

Blerinda Velu – Zyrtare e projektit

Brendan Millan – Vullnetar i Peace Corps

Tabela e përmbajtjes

Shënim i Autorit.....	3
Lista e grafikoneve.....	5
Lista e Tabelave dhe e Figurave	5
Shkurtesat.....	6
Falënderimet	7
Abstrakti.....	8
Hyrje	9
Prapavija e Sektorit të Kulturës në Mitrovicë	10
Deklarata e problemit.....	12
Metodologjia e Hulumtimit.....	13
Metoda e Përzier Konvergjente.	14
Hulumtimi Primar.....	14
Hulumtimi Sekondar.....	15
Analiza	16
Kultura si Shtyllë e 4-ët e Zhvillimit të Qëndrueshëm.....	16
Situata aktuale në sektorin kulturor në Mitrovicë	18
Analiza SWOT e sektorit kulturor në Mitrovicë.....	25
PEST Analiza	36
Politike/Legale.....	36
Ekonomike.....	37
Sociale / Kulturore.....	38
Teknologjike.....	38
Diskutimi i të gjeturave.....	39
Përmbyllja	41
Rekomandimet	42
Referencat	45

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Lista e grafikoneve

- **Grafiku 1.** Krahاسimi i buxhetit për DKRS për 2016/ Burimi: Planifikimi Buxhetor për 2016 – Mitrovicë/ kk.rks-gov.net
- **Grafiku 2.** Krahاسimi i buxhetit për DKRS për 2014/ Burimi: Planifikimi Buxhetor per 2016 – Mitrovicë/ kk.rks-gov.net
- **Grafiku 3.** “Fondet publike duhet të shpenzohen për aktivitete artistiko-kulturore”/ Burimi: Hulumtim primar “Pyetësorë për hulumtime në ekspozimin e aktiviteteve kulturore, dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në zhvillimin e politikave kulturore”
- **Grafiku 4.** “Arti dhe kultura ndihmojnë turizmin në Mitrovicë”/ Burimi: Hulumtimi primar – “Pyetësor për hulumtimin mbi ekspozimin ne aktivitet kulturore, dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në zhvillimin e politikave kulturore”
- **Grafiku 5.** “Aktivitetet artistike e bëjnë Mitrovicën vend tërheqës” / Burimi: Hulumtim primar - “Pyetësor për hulumtimin mbi ekspozimin ne aktivitet kulturore, dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në zhvillimin e politikave kulturore”
- **Grafiku 6.** “ A mendoni se në Mitrovicë ka mjaft ngjarje kulturore” Burimi: Hulumtim primar - “Pyetësor për hulumtimin mbi ekspozimin ne aktivitet kulturore, dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në zhvillimin e politikave kulturore”
- **Grafiku 7.** “Në qoftë se në Mitrovicë nuk ka mjaft ngjarje kulturore, Kush mendoni se është përgjegjës”

Lista e Tabelave dhe e Figurave

- **Tabela 1.** Punim BA, Projektimet për Metodologjinë Hulumtuese/ Burimi: Dizajnuar nga Berna Xhemajli dhe Blerinda Velu
- **Figura 1.** Metoda konvergjente për dizajnimin e diagramit/ Burimi: Metoda për Hulumtimin e Biznesit, Cooper 2001
- **Figura 2.** Zhvillimi i qëndrueshëm i trekëndëshit të përberë nga dimensionet ekonomike, shoqërore dhe mjedisore / Burimi: Banka Botërore 2001

Shkurtesat

DKRS – Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

MKRS – Ministria për Kulturë, Rini dhe Sport

IK – Institucionet Kulturore

OK – Operatorët Kulturorë

BT – Buxheti Total

GDP – Gross Domestic Product

PH – Projekt Hulumtues

QM – Qytetarët e Mitrovicës

AP- Artistë të Pavarur

A&PM- Artistët dhe Profesorët e Muzikës

RROK – Rrjeti i Organizatave Kulturore -Mitrovicë

Falënderimet

Ne, shprehim mirënjohjen tonë ndaj Community Building Mitrovica (CBM), si dhe Centre for Resources, Youth, and Media Coalition (CYRM) për mbështetjen e tyre financiare të kësaj iniciative. Falënderimet tona të singerta i drejtohen edhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport (DKRS) për asistencën e tyre në qasje të informatave. Gjithashtu, do të ishim neglizhent mos të përmendnim Rrjetin e Organizatave Kulturore të Mitrovicës (RrOK), për këshillat dhe rolin kyç në kompletimin e suksesshëm të këtij hulumtimi.

Ne jemi veçanërisht mirënjohës ndaj të gjithë të anketuarve përmes pyetësorëve, si dhe ndaj atyre që kanë marrë pjesë në debate të hapura, fokus grupe dhe intervista. Kontributi nga këta individë me të vërtetë ka bërë një avancim në përpjekjet tona për një narracion të ndershëm dhe të besueshëm

E fundit por jo më pak e rëndësishme, mirënjohja jonë shkon edhe për OJQ-në "EC Ma Ndryshe" nga Prizreni, për ndarjen e përvojave dhe ekspertizës së tyre në zhvillimin e politikave kulturore.

OJQ "7Arte"

Sekretariati i RrOK Mitrovica

Abstrakti

Studimi hulumton gjendjen e tanishme të sektorit kulturor në Mitrovicë (Jug) përmes SWOT analizës, komponentët e së cilës lejojnë matjen e indikatorëve kyç në qëndrueshmërinë e sektorit. I tërë ky ushtrim adreson pyetjen hulumtuese, “Si ndikon mungesa e një Strategjie zyrtare Kulturore në zhvillimin e sektorit kulturor në Mitrovicë (Jug)?”

Një sasi e konsiderueshme e burimeve primare dhe sekondare janë përdorur që të sigurojnë të dhëna të sigurta dhe përgjigje valide në pyetjen hulumtuese. Mjetet hulumtuese të implementuara përfshijnë: pyetësorët- të cilët janë shpërndarë tek qytetarët në nivelin lokal për të identifikuar gjendjen kulturore të komunitetit nga perspektiva e tyre; intervistat- të cilat janë bërë me operatorët kulturorë për të parë nga perspektiva e tyre gjendjen kulturore, veçanërisht në krahasim me kohërat e më hershme; si dhe dy debate grupore dhe dy fokus grupe janë shtuar në aktivitetet e hulumtimit primar me arsye të vetme që të ngritet kredibiliteti i hulumtimit.

Hulumtimi siguron dhe nxjerr në pah të dhëna sa i përket gjendjes dhe sfidave në skemën kulturore në Mitrovicë (Jug), krahason mendimet nga institucionet e ndryshme, operatorët, akterët, dhe qytetarët. Më gjerësisht, hulumtimi analizon gjendjen kulturore dhe përcakton nëse mungesa e Strategjisë Kulturore ndikon negativisht në jetën kulturore të komunitetit.

Fjalët kryesore: Kultura, Sektori Kulturor, Institucionet Kulturore, Politikat Kulturore, Buxheti për Kulturë.

Hyrje

Në një formë figurative, qyteti i Mitrovicës, qysh prej mbarimit të Luftës së Dytë Botërore e edhe më parë, ka tërhequr qytetarë nga i gjithë regjioni duke e pasuruar me llojllojshmëri të kulturave të cilat në të shumtën e rasteve bashkëvepruan në fusha të ndryshme me interes, duke mos përjashtuar edhe bashkëpunimet në fusha të ndryshme kulturore. Herë duke iu përshtatur, herë duke iu rezistuar sistemeve qeveritare dhe ndikimeve të ‘më të fortëve’, shoqëria mitrovicase arriti të zhvillojë një kozmopolitet të brendshëm dhe të ndërtojë grupe elitare që njiheshin edhe si shtresë avangarde të kulturës, jo vetëm në Mitrovicë, por në nivel kombëtar.

Qytetarët e Mitrovicës, ata të cilët dikur ishin pjesë e proceseve zhvillimore në fushën e kulturës, me shumë nostalgji flasin dhe kujtojnë ditët kur qyteti i Mitrovicës mbante epitelin e një qyteti kulturor, duke tërhequr audiencë e vizitorë nga mbarë Kosova dhe rajoni.

Pas shpërbërjes së Jugosllavisë dhe luftës së fundit në Kosovë, gjeneratat e reja sikur janë shkëputur nga i gjithë ai proces zhvillimor dhe kur flitet për kulturën, marrin për bazë tregimet e përvojat e prindërve të tyre dhe i japin një kuptim kryesisht pozitiv mbi zhvillimet kulturore në vend. Duke qenë se kultura lidhet drejtpërdrejtë edhe me liritë dhe të drejtat e njeriut, situata e shqiptarëve nën sistemin e Jugosllavisë, e aq më shumë zhvillimi kulturor gjatë asaj kohe, meriton një trajtim e studim të veçantë, që do duhej trajtuar në punime hulumtuese të tjera.

Sot, gati pas tri decenieve, për shumicën shqiptare në qytetin e Mitrovicës, gjendja e tanishme kulturore shpeshherë arsyetohet me pasojat e luftës, fazës transitore të ndërtimit të institucioneve, ndarjen e qytetit, ikjen e artistëve nga vendi, me mos funksionimin e Kombinatit Trepça sikur në kohërat e Jugosllavisë, me mos demokratizimin e shoqërisë, e me degradimin e

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

vlerave kulturore. Të gjitha këto kryesisht thuhet hapas në debate publike apo edhe në takime jo-formale, por deri më sot këto çështje nuk janë trajtuar në forma më shkencore dhe të argumentuara mjaftueshëm me fakte. Posaçërisht, mbi atë se cilët janë faktorët me më shumë ndikim e cilët me më pak ndikim rreth situatës së tanishme në sektorin e kulturës.

Me gjithë sfidat e shtet-ndërtimit dhe fuqizimit të shoqërisë civile në Kosovë, fusha e kulturës mbase asnjëherë nuk është trajtuar me qasje hulumtuese e analitike, prej nga do të dilnin të dhëna statistikore mbi gjendjen e kulturës në Komunën e Mitrovicës Jugore.

Si nevojë e domosdoshme për të nxjerr një analizë të gjendjes kulturore, organizata 7Arte në cilësinë e sekretariatit të rrjetit të organizatave kulturore në Mitrovicë, RROK Mitrovica, ka marrë përsipër (me mbështetjen e donatorëve) hulumtimin e gjendjes së përgjithshme kulturore në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Pritet që ky hulumtim, i pari i këtij lloji për sa i përket zhvillimeve të kulturës në vend, do shërbejë si një analizë fillestare prej së cilës do mund të nxirren çështje të rëndësishme në pah, e që do i shërbente qoftë institucioneve, shoqërisë civile apo edhe studiuesve të interesuar mbi gjetjen e mundësive më të mira që do të qonin drejtë një zhvillimi të qëndrueshëm kulturor në Mitrovicë.

Prapavija e Sektorit të Kulturës në Mitrovicë

Bartëse kryesore për zhvillimin kulturor në Komunën e Mitrovicës është Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport (Komuna e Mitrovicës) dhe si e tillë ka për detyrë të zhvillojë vizion të qartë si dhe politika gjithëpërfshirëse për zhvillimin e kulturës në Komunën e Mitrovicës. Institucionet kulturore varëse, që janë nën menaxhimin e DKRS-së janë: Biblioteka komunale “Latif Berisha, Muzeu i Qytetit, Teatri i Qytetit të Mitrovicës, Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve, Qendra e Kulturës “Rexhep Mitrovica”, si dhe Galeria e Artit”.

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Në anën tjetër, qysh prej viteve të 90'ta në komunën e Mitrovicës janë themeluar shoqata kulturore të cilat pavarësisht sfidave të ndryshme kanë vazhduar të kontribuojnë në zhvillimet kulturore. Që nga viti 2001 e deri më sot, ka një rritje të hovshme për inicimin dhe regjistrimin e organizatave jo-qeveritare në regjionin e Mitrovicës, ani pse në anën tjetër, një numër i vogël i tyre janë përcaktuar dhe profilizuar të veprojnë në fushën e kulturës. Në anën jugore të Mitrovicës, janë rreth 20 organizata kulturore të cilat plotësojnë nevojat e ndryshme që janë shfaqur në sektorin e fushës së kulturës. Kryesisht dominojnë organizatat të cilat janë fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve muzikore, teatrale, arteve pamore, kinemasë dhe artizanaleve. Me rritjen e nevojës për të prodhuar art dhe aktivitete që edukojnë dhe pasurojnë jetën shpirtërore të qytetarëve, është rritur edhe nevoja për qasje më të madhe në fondet publike, e njëkohësisht është rritur nevoja për t'i dhënë legjitimitetin e duhur dhe kahje zhvillimore skenës kulturore.

Me themelimin e Forumit Kulturor, si një platformë e organizatave të pavarura kulturore nga e gjithë Kosova, si dhe me shembujt pozitiv të marrë nga organizatat si: Ec ma Ndryshe dhe ODA, të cilat veç kishin iniciuar zhvillimin e politikave në 5 komuna të Kosovës, u shtua nevoja për organizim të brendshëm të organizatave kulturore që veprojnë në komunën e Mitrovicës, andaj nisma e iniciuar nga 7Arte që mirëpritur nga një numër i konsiderueshëm i organizatave lokale dhe pas disa takimesh, më konkretisht në mars të vitit 2014, u themelua Rrjeti i Organizatave Kulturore të Mitrovicës, i njohur shkurtimisht si RROK-Mitrovica.

Misioni i RROK Mitrovica është që të zhvillojë dhe koordinojë aktivitetet kulturore dhe industrinë kreative në nivel lokal, si një faktor strategjik drejtë zhvillimit ekonomik të qytetit dhe diversitetit kulturor.

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Objektivat themelore të RrOK- Mitrovica përfshijnë: ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, ngritjen e cilësisë së aktiviteteve ekzistuese kulturore, ofrimin e shërbimeve alternative kulturore e turistike, asistimin drejtë zhvillimit të politikave kulturore në nivel komunal, krijimin e partneritetit me institucionet relevante në nivel lokal e nacional, zhvillimin e industrisë kreative, promovimin e trashëgimisë kulturore dhe nxitjen e qytetarisë aktive përmes aktiviteteve inovative e kulturore.

Organizatat themeluese të RrOK, sipas renditjes alfabetike janë: 7Arte, Ad Libitum, Bridge Film Fest, Darda Media, Hair Kosova, IQDNJ, Kosovaars, Kriterion-Mitrovica, Mitrovica Rock School, Mundësia, SHAV-M, Shoqata e Artistëve Figurativ, Shoqata e Muzicjentëve të Mitrovicës. Duke qenë se rrjeti është i hapur edhe për organizata dhe individë që veprojnë në skenën kulturore, ky rrjet pretendon të zgjerohet dhe luaj një rol aktiv në vitet në vijim.

Deklarata e problemit

Deklarata e problemit ka për bazë origjinën dhe perceptohet si mungesë e aktiviteteve të qëndrueshme kulturore në shoqëri. Bazuar nga të dhënat prej katër grupeve (institucioneve, operatorëve, artistëve të pavarur, dhe qytetarëve), ky dokument ka hipotezën se mungesa e strategjisë zyrtare për kulturë është faktori kyç për të dal nga kjo situatë. Pyetja hulumtuese që nxori këto perspektiva është si vijon:

“Si ndikon mungesa zyrtare e strategjisë kulturore në sektorin kulturor dhe zhvillimin e tij në Mitrovicën (Jugore)?”

Metodologjia e Hulumtimit

Zgjedhja e metodologjisë për hulumtim ose filozofia e hulumtimit është primare gjatë vendosjes për të bërë një projekt hulumtues. Identifikimi i metodologjisë hulumtuese ofron metoda të ndryshme për qasje, edhe pse limitimet mund të imponohen në hulumtim (Knox, 2004).

Objektiva kryesore e studimit – e para e këtij lloji – është të prodhojë hulumtim kuantitativ dhe kualitativ, marrje të të dhënave valide që lidhen me politikat kulturore dhe situatën e skemës kulturore në Mitrovicë. Për më shumë, ky studim përmban të dhëna primare dhe sekondare. Dizajni i metodologjisë hulumtuese është përcaktuar në mënyrë të ndërlidhur, si në tabelën e mëposhtme:




Tabela 1. BA punim diplome, metodologjia dhe projektimet për hulumtim/ Burimi: Dizajnuar nga Berna Xhemajli dhe Blerinda Veliu

Metoda e Përzier Konvergjente. Për shkak të kuptimit më të gjerë të informatave kualitative dhe kuantitative, të dyja radhiten në nivel të barabartë në vlerën analitike, metodologjia inkorporon Dizajnin e Përzier të Metodës Konvergjente (CMMD).




Figura 1. Dizajni për diagramin e metodës konvergjente/ Burimi: Metoda e hulumtimit të biznesit, Cooper 2011

Ashtu siç është shfaqur në figurën më lartë, CMMD lejon që hulumtuesi të mbledhë të dhëna kualitative dhe kuantitative njëkohësisht, përzien bazën e të dhënave, dhe bashkon rezultatet gjatë interpretimit (ndonjëherë gjatë analizës së të dhënave).

Hulumtimi Primar. Burimet primare me të dhëna janë përdorur për të kompletuar të dhënat nga burimet sekondare. Mjetet me të cilat është zhvilluar hulumtimi primar përfshijnë:

Intervistat – biseda të detajizuara dhe gjysmë-të-strukturuara, të realizuara me operatorët kulturorë që të marrim perspektivat e tyre për këtë çështje. Modeli Toulmin i cili është pjesë e këtij aktiviteti ofron dialog të hapur dhe nxitë për ide të reja përgjatë procesit të intervistimit.

Pyetësorët – Një sasi prej 100 pyetësorëve është shpërndarë tek popullata dhe janë regjistruar opinionet e qytetarëve që ta analizojmë perspektivën për aktivitetet kulturore në vend. Metoda e shpërndarjes është praktikuar, dhe etiketuar si mostër me variacion maksimal, që përmbledh rangun më të gjerë praktik si mosha, gjinia, dhe përkatësia etnike. I gjithë ky diverzitet vetëm sa i fuqizon konstatimet tona.

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Debatet – Dy debate të ndara (“Politika dhe kultura në Mitrovicë” dhe “Arti dhe Kultura në institucionet në Mitrovicë”) (shiko shtesën D dhe E) mblodhën opinionet, idetë dhe eksperiencat e njerëzve kompetent, idetë dhe eksperiencat e të cilëve ishin paraparë më se relevante në këtë hulumtim specifik.

Fokus grupet – Dy sesione me fokus grupe të ndara janë mbajtur me qëllim të konstruktimit të analizës së parë SWOT për sektorin kulturor në Mitrovicën Jugore. Fokus grupi i parë është mbajtur me përfaqësues nga institucionet kulturore, të cilët kontribuan në modelin e parë të SWOT analizës. Fokus grupi i dytë është mbajtur me aktivistët për kulturë, artistët e pavarur, profesorët e artit, dhe qytetarët të cilët kanë interes në fushën e kulturës. Pjesëmarrësve të sesionit të dytë i’u është shfaqur modeli i parë analitik dhe janë pyetur për mendimet e tyre rreth SWOT analizës. Këto të dhëna janë inkorporuar dhe përshtatur me vlerësimet e nxjerra dhe kemi arritur deri tek kompletimi i verzionit final të analizës SWOT.

Hulumtimi Sekondar. Të dhënat sekondare rrjedhin nga dokumentet për zhvillim nga kuvendi komunal, raportet vjetore nga autoritetet lokale për kulturë, raportet nga Forumi Kulturor, dhe hulumtime të ndryshme për zhvillimin e kulturës në shtetet e ndryshme. Materialet nga burimet sekondare janë përdorur si përkrahëse të konstatimeve tona, me shembuj teorik dhe studime të rasteve.

Analiza

Kultura si Shtyllë e 4-ët e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Sipas komisionit Brundtland (komisioni botëror për Zhvillim dhe Mjedis), zhvillim i qëndrueshëm është zhvillimi i cili përmbush nevojat, pa kompromis, të aftësive të gjeneratave të ardhshme që të përmbushin nevojat e veta.

Zhvillimi i Qëndrueshëm është prezantuar më 1992, Munasinghe (Rogers, 2008, nr.23) i njohur që mbahet nga tre shtyllat që janë të njohura si tre (3) shtyllat e zhvillimit të qëndrueshëm: Ekonomike, Kulturo-Shoqërore dhe e Mjedisit; shtylla ekonomike përfshinë: rritjen, eficiencën dhe stabilitetin (rritjen e të hyrave, përgjatë mirëmbajtjes konstante të rezervave të kapitalit) shtylla Kulturo-Shoqërore: përfshinë: fuqizimin/qeverisjen, përfshirjen/konsultimet, institucionet/vlerat (mirëmbajtjen stabile të sistemeve shoqërore dhe kulturore) dhe shtylla për Mjedis përfshinë: ri-përtëritje, resurset natyrore, dhe ndotjen (mirëmbajtja e forcës ri-përtëritëse të sistemeve fizike dhe biologjike). Megjithatë, për një kohë në këtë trekëndësh “kultura” nuk përmendet si shtyllë pas shtyllës së “shoqërisë”, siç mund të shihet në figurën më poshtë, e cila buron nga Banka Botërore, dhe shpjegon dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe lokacionit.




Figura 2. Tre (3) shtyllat e Zhvillimit të Qëndrueshëm: Ekonomik, Kulturo-Shoqëror dhe i Mjedisit/ Burimi: Banka Botërore 2001

Kultura referohet si depozitimi i mbledhur i diturisë, përvojës, besimeve, vlerave, qëndrimeve, kuptimeve, hierarkive, religjionit, nocioneve kohore, roleve, relacioneve, koncepteve të universit, objekteve materiale dhe posedimeve të zhvilluara nga një grup i njerëzve nëpër gjenerata dhe nëpërmjet individëve dhe grupeve. Me fjalë të tjera kultura identifikon kombin, vendin. Pavarësisht nga vlera për ndjenjën që të jenë pjesë e kulturës, kjo ju ofron njerëzve sensin për identitet dhe qëllim, UNESCO, organizatë mjaft e rëndësishme globale ka filluar iniciativën e rëndësishme për ndikimin e kulturës në zhvillimin ekonomik të vendit. Kështu që, konsiderimi për rëndësinë e kulturës dhe ndikimit që ka në zhvillimin e vendit, UNESCO, e ka filluar iniciativën për vendosjen e kulturës brenda sistemit për zhvillim të qëndrueshëm.

Në vitin 2010 dhe 2011 kemi pasur dy rezoluta të Ambasadës së Përgjithshme mbi “Kulturën dhe Zhvillimin”, të cilat thirren për integrimin e kulturës brenda politikave dhe strategjive për zhvillim, duke i dhënë vlerë kulturës për zhvillim të qëndrueshëm: më 2013

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Rio+20 bëri referenca të qarta për kulturën: rezultati i dokumentit referoi rëndësisë së diversitetit kulturor për zhvillim të qëndrueshëm, dhe lidhjes ndërmjet njerëzve, ekosistemeve dhe traditave kulturore, rëndësisë për investimin në turizmin kulturor, nevojës për ruajtjen e distrikteve kulturore, njohu lidhjen ndërmjet kulturës dhe bio-diverzitetit, dhe përdorimin e qëndrueshëm të resurseve nga komunitetet lokale.(UN, 2011-2013)

Për më shumë, në Qershor të vitit 2013 (New York), Asambleja e Përgjithshme e UN organizoi debatin me temën “Kultura dhe Zhvillimi”, që solli 250 pjesëmarrës. Ky debat ishte hapur nga sekretari gjeneral i UN Ban-Ki-Moon bashkë me presidentin e Asamblesë së Përgjithshme, me pjesëmarrjen UNESCO DG, Administrata e UNDP, Presidenti i AoC, dhe 14 ministra të qeverisë, të cilët theksuan rolin e kulturës për arritjen e qëllimeve. Gjatë debatit G-77 plus Kina, EU dhe CELAC (Komuniteti Amerikano Latin dhe vendeve të Karaibeve) kërkuan që kultura të njihet në mënyrë eksplicite si nxitëse e zhvillimit të qëndrueshëm në agjendën për zhvillim global pas vitit 2015.

Qeveritë e vendeve në zhvillim janë po ashtu duke përkrahur rritjen dinamike të industrive kulturore dhe kreative. Në parim, sipas UNESCO, kultura (duke përfshirë industritë kreative) është konsideruar si shtytje për zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit ekonomik, ku njihet si gjenerues i të ardhurave, mjet i punësimit, rritjes ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm të jetesës, dhe ndikues në rritjen e një pjese të GDP-së në ekonominë në zhvillim. (UNESCO, 2015)

Situata aktuale në sektorin kulturor në Mitrovicë

Që nga periudha e pas-konfliktit, vlera e kulturës në Kosovë është konsideruar si instrument për lehtësimin e konfliktit në shoqërinë e rënduar, për njohjen e grupeve të nën-

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

përfaqësuar dhe ri-vitalizim për pjesët e anashkaluara. Kjo lejoi që operatorët kulturor në Kosovë të duken si lojtarë të rëndësishëm në promovimin e demokracisë dhe përfshirjen e ndërmarrësisë për zhvillimin ekonomik që mund të vijë nga sektori kulturor. (Kultura për të Gjithë, 2010-2012) Për më shumë sipas “Kultura për të Gjithë”, përgjatë dekadës së fundit, në Kosovë është rritur vetëdija për rëndësinë e dimensioneve kulturore dhe natyrën e vet, që gjen shprehje për mënyrën e jetës, praktikave të kulturës, sistemet për dituri dhe format e ndryshme të kreativitetit. Kjo perspektivë ka shkuar përpara mbi integrimin ndërkulturor me zhvillim të qëndrueshëm, inovacion dhe krijimin e vendeve të punës duke konsideruar kreativitetin individual, aftësitë dhe talentin për rritje potenciale, posaçërisht nëpërmjet rritjes nga akterët drejtpërdrejtë ose në mënyrë indirekte nëpërmjet industrive kreative. (Kultura për të gjithë, 2010-2012).

Edhe pse me të gjitha konsideratat pozitive që janë dhënë për kulturën dhe potencialin në ndikimin pozitiv që ka për zhvillimin ekonomik nga organizatat ndërkombëtare, dhe faktin që sipas UNESCO dhe WIPO impakti ekonomik për kulturë në nivel nacional shkon përtej pritjeve fillestare. Kjo është bazuar në indikatorët për matjen e kontributit të aktiviteteve kulturore në GDP dhe niveleve për punësim në kulturë. Shembull, nga të dhënat e mbledhura dhe të analizuar nga 40 shtete përmes WIPO zbulojnë se mesatarja e kontributit nga të drejtat industriale përfaqëson 5.2% të GDP (UNESCO/WIPO, 2005). Qeveria e Kosovës ende nuk e konsideron kulturën si prioritet, dhe është vetëm e paraqitur si nënkategori e edukimit, dhe e lënë jashtë listës së prioritetëve të vendit. (Forumi Kulturor, 2014)


Aq sa i kushtohet rëndësi kulturës mund të shihet përmes buxhetit për kulturë që është ndarë vitet e fundit, më 2014 buxheti i ndarë për Ministrinë për Kulturë Rini dhe Sport (MKRS) ishte rreth 20 milion EURO, ndërsa 25% e kësaj shumë është ndarë për kulturën dhe trashëgimit

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

kulturore, që është vetëm 0.36% e buxhetit total për Kosovë. (Forumi Kulturor 2014) Në vitin 2015 shuma e ndarë për MKRS ishte 21,800,207 EURO ndërsa në 2016, buxheti total i MKRS është 23,450,307 EURO (Buxheti Vjetor i Kosovës, 2015)

Kur e kthejmë vëmendjen te komunat dhe te Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport që p.sh në Mitrovicë sipas raportit vjetor të DKRS nga Mitrovica e Jugut për vitin 2015, janë shënuar vetëm 48 aktivitete në sektorin kulturor në Mitrovicë, përfshirë këtu aktivitetet tradicionale vjetore që janë organizuar nga OJQ-të. Sipas planit për buxhet për 2016-2018 nga DKRS, buxheti vjetor që është i ndarë për DKRS për 2016 është 548,326 Euro e që është vetëm 3% e buxhetit total të komunës së Mitrovicës. Për më shumë 297,447 Euro janë të ndara për rroga që është 54.25% e buxhetit total të DKRS. Siç mund të shihet nga grafiku 1 kjo përqindje është në disproporcion nëse krahasohet me linjat e tjera të buxhetit, më shumë rëndësi, me subvencionet dhe linjat për transfer, që është vetëm 13.75% (75,392) e buxhetit total të DKRS, ku prej kësaj shume 65,392 shkon për institucionet publike (teatri, libraria e qytetit, muzeu, ansambli i valleve, Qendra e Kulturës, Halla e Sporteve, etj.) dhe 10,000 janë të dedikuara për subjektet jo publike (kultura, sporti dhe OJQ-të e të rinjve) që është 13.26% e buxhetit total për subvencione.


ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË



Grafiku 1. Krahasoni i linjave për buxhet të DKRS-së për 2016/ Burimi:Planifikimi buxhetor për 2016 – Mitrovicë/kk.rks-gov.net


Për më shumë, kur plani për buxhet për 2016 është krahasuar me planin paraprak, atë të 2015, linja për rroga ashtu siç shihet në grafikun 2 ishte 41.23% e buxhetit total të DKRS, që është dukshëm në proporcion me linjën për subvencione (38.25% e buxhetit total të DKRS).

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË



Grafiku 2. Krahasimi i linjave për buxhet të DKRS për 2014/ Burimi:Planifikimi buxhetor për 2016 – Mitrovicë/kk.rks-gov.net

Siç mund të shihet nga grafikët 1 dhe 2 vëmendja e komunës është në disproporcion kur vijnë në pyetje linjat buxhetore, krahas faktit që 86% (shiko grafën 3) e qytetarëve të Mitrovicës besojnë se fondet publike duhet të shpenzohen në aktivitete kulturore/artistike.



ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Grafiku 3. *“Fondet publike duhet të shpenzohen në aktivitete kulturore/artisitike”* / Burimi: Hulumtimi Primar – “Pyetësorët për hulumtim mbi ekspozimin e aktiviteteve kulturore dhe pjesëmarrjen civile në zhvillimin e politikave për kulturë”


Sipas studimit “Kultura për të gjithë” (Program i BE) aktivitetet kulturore nga shumica e OJQ-ve mbeten të financuara nga donatorët ndërkombëtarë, ku më përkrahës dhe të involvuar në kulturë raportohet të jetë Pro-Helvetia, Soros, USAID, OSCE për grante për komunitete të vogla, Ambasadat, institucione kulturore të Francezëve, Gjermanëve dhe Zvicrane, sponzorimet private nga institucionet bankare për grantet më të mëdha.

Për më tepër përveç përkrahjes së dobët financiare që sektori kulturor pranon nga komuna e Mitrovicës, që shpreh mosbesimin nga ana e tyre në potencialin e kulturës në zhvillimin ekonomik, shembull i mirë që tregon se si kultura ose iniciativat e operatorëve kulturorë mund të kenë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik është rasti i DokuFest, që organizohet dhe mbahet në Prizren, dhe është tashmë një nga festivalet më të njohura në regjion dhe botë për dokumentarë dhe filma të shkurtër (Instituti GAP, 2016). Sipas GAP institutit, përveç aspektit kulturor, DokuFest ka ndikim të madh në ekonominë e Prizrenit dhe po ashtu të Kosovës. Ndikimi ekonomik i Dokufestit është vërtetuar në vitin 2015 përmes disa analizave, ku është bërë evaluimi dhe ndikimi i Dokufestit në GDP, me trendin e importit me 48%, arrin vlerën vjetore prej 2.4 milion EURO, ndërsa bashkë me shpenzimet e konsumimit, ndikimi vjetor është vlerësuar të jetë 4.7 milion EURO (GAP Institute, 2016).


Megjithatë, qytetarët e Mitrovicës kanë mendim të ndryshëm nga Institucionet lokale sa i përket potencialit kulturor, ku 96% e tyre besojnë se kultura ndihmon turizmin e Mitrovicës që është përqindje e lartë krahasuar me 4% që nuk pajtohen me këtë qëndrim. (Shih grafikun 4)

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Ndërsa, 90% e tyre (Shiko grafikun 5) besojnë që aktivitet artistike e bëjnë Mitrovicën vend tërheqës.



Grafiku 4. “Arti dhe kultura ndihmojnë turizmin në Mitrovicë”/ “Pyetësorët për hulumtim mbi ekspozimin e aktiviteteve kulturore dhe pjesëmarrjen civile në zhvillimin e politikave për kulturë”



Grafiku 5. “Aktivitet artistike e bëjnë Mitrovicën vend atraktiv”/ “Pyetësorët për hulumtim mbi ekspozimin e aktiviteteve kulturore dhe pjesëmarrjen civile në zhvillimin e politikave për kulturë”

Analiza SWOT e sektorit kulturor në Mitrovicë

Fuqitë	Dobësitë
- Resurset humane (njerëzit të cilët punojnë për kulturë - muzikantët, artistët e pavarur, piktorët, OJQ-të për kulturë) - Diverziteti kulturor - Trashëgimit kulturore (të luajtshme dhe të paluajtshme)/(Kulla e Isa Boletinit, Muzeu i Qytetit Ansambli i muzikës dhe valleve, zona industriale, etj)	- Mungesa e infrastrukturës kulturore - Mungesa e vazhdimësisë të aktiviteteve kulturore - Jo bashkëpunimi i (Operatorëve kulturor dhe institucioneve kulturore) - Fondet e dobëta - Përdorimi i gabuar i hapësirave kulturore - Mungesa konkrete e politikave kulturore në komunën e Mitrovicës - Programi komunal për bursa (pa ndonjë prioritet për kuadrot deficitare) - Mungesa e profesionistëve në fushat kulturore (arkeologji, kostumografi, skenografet, dramaturg, tekniket për ndriçim, etj.) - Nepotizmi dhe politizimi i institucioneve kulturore - punësimi i njerëzve joadekuat/jo-profesional.
Mundësitë	Rreziqet
- Zëvendësimi i gjeneratave të vjetra me të reja - Iniciativa globale për kulturë si shtylla e katërt e zhvillimit të qëndrueshëm - Infrastruktura e papërdorur e Trepçës - Integrimi dhe partneriteti me institucionet dhe organizatat nga rrjete ndërkombëtare - Integrimi në BE - Diaspora - Identifikimi dhe promovimi i zonave të pasura arkeologjike në regjionin e Shalë Bajgores	- Zvogëlimi i vazhdueshëm i fondeve për sektorin e kulturës dhe tërheqja e donatorëve ndërkombëtar - Situata e rëndë politike (konflikti ndër-etnik) - Migrimi i vazhdueshëm i artistëve dhe të rinjve me potencial nga fusha kulturore - Privatizimi i infrastrukturës kulturore - Degradimi i monumenteve të mbrojtura si pjesë e trashëgimisë së paluajtshme

Fuqitë

Resurset Njerëzore

Resurset njerëzore konsiderohen si fuqi e sektorit kulturor në Mitrovicën e jugut, sepse mjaft individë e grupe të organizatave punojnë dhe janë entuziast për zhvillimin e kulturës, duke përfshirë këtu, muzikantët, piktorët, artistët e pavarur, dhe OJQ-të për kulturë.

Diverziteti Kulturor

Pasi që Mitrovica është e njohur si njëra prej qyteteve më larshmërinë më të madhe të komuniteteve, të cilat jetojnë dhe ndajnë mjedisin e njëjtë, ky aset e bën qytetin e Mitrovicës të jetë dukshëm më i pasur për nga larshmëria kulturore.

Trashëgimia kulturore

Këtu përfshihen objektet e luajtshme dhe të paluajtshme; Mitrovica e Jugut është e pasur me trashëgimi kulturore, duke përfshirë këtu objektet si: ura e qytetit, muzeu i kristaleve dhe Isa Boletinit, Muzeu i qytetit, Hamami i qytetit, shtëpitë e Xhafer Devesë, zonat industriale, bukuritë natyrore, besimet, gjuhët e ndryshme, doket e zakonet që së bashku bëjnë një bazë të mirë të trashëgimisë kulturore.

Dobësitë

Mungesa e infrastrukturës kulturore


Pas luftës qyteti ka qenë i dëmtuar e bashkë me të edhe infrastruktura kulturore po ashtu, dhe në situatën aktuale mungesa e hapësirave adekuate ku aktivitete të ndryshme do mund të

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

zhvilloheshin, është parë si dobësi që ndikon në zhvillimin e jetës kulturore dhe po ashtu në motivimin dhe dekurajimin e njerëzve që punojnë në këtë fushë.

Mungesa e vazhdueshme e aktiviteteve kulturore

Edhe pse agjenda e sektorit kulturor në Mitrovicë ka disa aktivitete tradicionale për raste të ndryshme si: dita e pavarësisë, dita e flamurit, etj., ende sipas të dhënave të mbledhura nga qytetarët, këto aktivitete kanë agjendën e njëjtë çdo vit.



Grafiku 6 “A mendoni se ka ngjarje të mjaftueshme kulturore në Mitrovicë”/ “Pyetësorët për hulumtim mbi ekspozimin e aktiviteteve kulturore dhe pjesëmarrjen civile në zhvillimin e politikave për kulturë”

Për më tepër, sipas të dhënave nga pyetësorët me qytetarët, shkalla e përgjigjeve në pyetjen, nëse në Mitrovicë ka mjaft aktivitete kulturore (shiko grafikun 6) është dukshëm e lartë, ku 95% e të intervistuarve u përgjigj me JO, dhe vetëm 5% u përgjigj me PO.

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Mos- bashkëpunimi (Operatorët kulturor dhe Institucionet kulturore)

Dobësia tjetër që është identifikuar në sektorin kulturor është mungesa dhe jo-bashkëpunimi ndërmjet institucioneve kulturore dhe operatorëve kulturor, që në mënyrë të konsiderueshme mund të shihet si kërcënim kur të vij puna tek zhvillimi i këtij sektori.

Fondet e ulëta


Kur vjen deri te zhvillimi i jetës kulturore në Mitrovicë dhe mbajtjes gjallë në jetë e aktiviteteve tradicionale dhe eventeve/aktiviteteve të tjera, krejt ajo çfarë iu ipet DKRS-së (Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport) nga buxheti komunal, konsiderohet të jetë dukshëm e ulët. Në vitin 2014 sektori kulturor ka pasur 120,000 Euro për aktivitete kulturore, krahasuar me 2016 kur është zvogëluar në 70,000 Euro. Është me rëndësi të përmendet që prej kësaj shume, vetëm 24,000 Euro janë planifikuar për zhvillimin kulturor dhe këtu janë të përfshira nevojat për institucionet kulturore si (Muzeu i qytetit, shtëpia e kulturës, teatri i qytetit, ansambli i valleve, dhe galeria e artit) dhe pjesa e mbetur mund të alokohet si subvencion për organizatat e pavarura kulturore nga sektori i shoqërisë civile në Mitrovicë.

Mos-shfrytëzimi adekuat i hapësirave nën menaxhim të komunës

Fenomeni tjetër që është identifikuar si dobësi nga operatorët kulturor dhe sipas të cilëve, ka mjaftë hapësira publike që janë dhënë nga komuna për disa OJQ e subjekte tjera dhe të cilët i kanë mbyllur këto hapësira dhe krahas jo-përdorimit të tyre, ata janë duke ia mohuar mundësinë e shfrytëzimit të tjerëve, të cilët do ti përdornin këto hapësira për zhvillimin aktiviteteve të tyre.

Mungesa e politikave gjithëpërfshirëse për kulturë në komunën e Mitrovicës

Bazuar në raportin në lidhje me debatin “Kultura në komunitet e Kosovës”, përgatitur nga Forumi Kulturor, z. Kujtim Isa, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, tha: “tashmë ne kemi një kalendar të caktuar me aktivitetet të cilat i organizojmë, siç është festa e pavarësisë ose disa data të tjera të rëndësishme”. Është me rëndësi të përmendet që brenda tre viteve, si rezultat i vendimeve politike, dy drejtorë të DKRS janë ndërruar (z. Kujtim Isa, dhe z. Ardian Kavaja) për të ia lënë postin drejtorit të ri z. Tafil Peci. Secili ka pasur pikëpamjen e vetë në lidhje me zhvillimin e kulturës në Mitrovicë dhe zëvendësimi ndikoi drejtpërdrejtë në ritmin dhe procesin e zhvillimit të aktiviteteve kulturore në Mitrovicë. Komuna e Mitrovicës është ndër komunitet e rralla që nuk ka prodhuar/ hartuar ndonjë strategji gjithëpërfshirëse për kulturë.



Grafiku 7 “Nëse në Mitrovicë nuk ka aktivitete të mjaftueshme kulturore, Kush mendoni se është përgjegjës?” / Burimi: “Pyetësorët për hulumtim mbi ekspozimin e aktiviteteve kulturore dhe pjesëmarrjen civile në zhvillimin e politikave për kulturë”

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Sipas perspektivës së qytetarëve situata aktuale e sektorit kulturor, siç është e referuar te grafiku 7, më shumë se 65.98% e të interesuarve theksuan se arsyeja kryesore e mungesës së aktiviteteve kulturore në Mitrovicë është për shkak të mungesës së politikave dhe strategjisë për kulturë (nga institucionet). Ndërsa 34.02% besojnë se arsyeja për këtë problem është aktivizimi jo i mjaftueshëm i shoqërisë civile.

Mungesa e profesionistëve në fushën kulturore

Sipas institucioneve kulturore, sektori kulturor në Mitrovicën e Jugut ka mungesë të profesionistëve në fushat e ndryshme të kulturës si: arkeolog, kostumograf, skenograf, regjisor të shfaqjeve, teknikë për ndriçim, etj. Ky fenomen është konsideruar si dobësi për të ndërtuar një zgjidhje/ vizion të qartë që ndikon drejtpërdrejtë në zhvillimin e sektorit kulturor në Mitrovicë.

Nepotizmi dhe politizimi i institucioneve kulturore

Punësimi i njerëzve jo të duhur/jo profesional – këto dy dukuri (nepotizmi dhe politizimi) janë mjaft të popullarizuara në çdo institucion në Kosovë, dhe bisedë e përditshme në mes të qytetarëve. Në parim, janë fenomene që sipas operatorëve kulturorë në Mitrovicë ndikojnë negativisht në funksionimin dhe zhvillimin e sektorit kulturor.

Mundësitë

Ndërrimi i gjeneratave të vjetra me ato të reja (Sektori Kulturor)

Sipas observimeve dhe operatorëve kulturor, administrata publike dhe shërbimet në Kosovë janë vendet ku 80% e të punësuarve janë në moshë mesatare dhe të vjetër. Megjithatë zëvendësimi i këtyre gjeneratave me ato të reja shihet të jetë me vlerë dhe mundësi e mirë që gjeneratat e reja janë mirë të edukuara, të rinjtë që i takojnë sistemit demokratik, dhe koha kur

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

puna ekipore, menaxhimi i kohës, efienca dhe motivimi shihen si shumë me vlerë për kryerjen e punëve. Kështu që një gjeneratë e re, dhe ndryshe nga kjo, konsiderohet si potencial për ndryshime pozitive për institucionet publike të Kosovës, duke përfshirë këtu sektorin kulturor në Mitrovicën e jugut.

Iniciativa globale “Kultura si shtyllë e katërt e zhvillimit të qëndrueshëm”

Siç është përmendur në pjesën e parë të analizës, edhe pse kultura është prezantuar si bashkë-shtyllë në shpalljen e parë të zhvillimit të qëndrueshëm nga Munasinghe në 1992, më vonë gjatë viteve kultura nuk është përmendur si bashkë-shtyllë e zhvillimit të qëndrueshëm, kështu që UNESCO me hulumtimet dhe faktet e tyre, filloi iniciativën dhe shpalsjen e potencialit të kulturës që ndikon pozitivisht në zhvillimin ekonomik brenda shteteve, veçanërisht në vendet në zhvillim. Kjo iniciativë ka qenë e mirëseardhur për shumë vende, dhe është konsideruar si një mundësi e mirë që do ti hapte dyert, dhe krijonte mundësi edhe për zhvillim të kulturës në Kosovë dhe në Mitrovicë në veçanti. Iniciativë e ngjashme është Agjenda 21, që është e implementuar vullnetarisht nga plani për aksion i Kombeve të Bashkuara, në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm. Është prodhim i Earth Summit (UN Konferenca mbi Mjedisin dhe Zhvillimin) e mbajtur në Rio de Janeiro, Brazil, më 1992. Kështu, nëse qytetet/komunat dëshmojnë që ta konsiderojnë kulturën si shtyllë për zhvillimin e qëndrueshëm dhe investimin në të, Agjenda 21 për kulturë (UCLG – Qytetet e Bashkuara dhe Qeveritë Lokale) lejon shkëmbimin e eksperiencave; përmirëson mësimin e dyanshëm dhe formon rrjetin për zhvillimin e projekteve.

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Infrastruktura e përdorur industriale e Trepçës

Krahasuar me qytetet e tjera në regjion, Mitrovica është njohur gjithmonë si qytet industrial. Historia e minierave në këtë regjion buron që nga kohët e lashta. Në fillim të shekullit XX janë ndërtuar shumë ndërtesa që janë dedikuar industrisë së Trepçës. Që nga 1989 kur Slllobodan Milosheviçi suprimoi autonominë e Kosovës, zhvillimi industrial gati sa nuk bankrotoi. Shumë ndërtesa industriale u shkatërruan dhe nuk u përdorën. Për të shumtën e tyre nuk ka ide se çka do të ndodhë. Organizata 7Arte propozoi krijimin e planit për rivitalizimin e këtyre zonave në mënyrë që të përdoren nga njerëzit dhe subjektet kulturore dhe industrisë kreative. Disa prej objekteve të zonës industriale do duhej t'iu takonin qytetarëve dhe të shndërrohen në hapësira publike.

Integrimi dhe partneriteti me institucionet dhe organizatat në Rrjetet Ndërkombëtare

Është konsideruar si mundësi e mirë për zhvillimin e sektorit kulturor në Mitrovicën e Jugut, veçanërisht për operatorët kulturor, nëse institucionet kulturore dhe OJQ-të kulturore integrohen në rrjetet ndërkombëtar, kjo i lejon ata ti takojnë operatorët të tjerë kulturor ndërkombëtar që ndajnë misionin dhe objektivat e njëjta, dhe i ofrohen mundësi për zhvillimin e mëtutjeshëm të lidhjeve që mund të prodhojnë aktivitete të përbashkëta dhe sjellin eksperiencë dhe ndryshime pozitive në Mitrovicë, po ashtu.

Integrimi në BE

Me integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian do të shfaqeshin më shumë mundësi për Kosovën dhe Mitrovicën në veçanti në çdo fushë, duke përfshirë edhe kulturën.

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Mërgata

Kosova është e njohur për numrin e madh të njerëzve jashtë kufijve të saj, të cilët për një ose arsye të tjera kanë migruar në shtetet e ndryshme. Kështu, kjo popullatë e njohur si “Mërgata” sipas entit për statistika konsiderohet një prej kontribuuesve për zhvillimin ekonomik në Kosovë gjatë sezonës së verës (kur ata vijnë të kalojnë pushimet verore me familjet e tyre). Megjithatë, “Mërgata” është mundësi e mirë për sektorin kulturor, jo vetëm sepse e sjell publikun në aktivitetet kulturore gjatë verës, por në ndërkohë shihet si mundësi e fuqishme që ndikon pozitivisht në zhvillimin e sektorit kulturor e ekonomik në Mitrovicën e Jugut.

Identifikimi dhe promovimi i zonave të pasura arkeologjike në regjionin e Shalës/Bajgorës

Regjioni i Mitrovicës, i takon dy kulturave, të Starcevo dhe Vinca të njohura në arkeologji si periudha që mbulojnë kohën Neolitike, 7000 vite më parë. Shumë vende dhe objekte janë gjetur në tre lokacionet në regjionin e Mitrovicës, si në: Zhitkovc, Fafos dhe Vallac. Përveç shumë kështjellave që i takojnë romakëve, bizantinëve, dhe perandorisë osmane, që nga vitet e 70-ta nuk ka pasur gërmime profesionale në këtë regjion. Regjioni i Shalës është i njohur për shumë lokacione të lashta dhe vendet që janë të njohura për njerëzit lokal, por këtu nuk ka investime për mbrojtjen dhe promocionin e këtyre vendeve. Qendra për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në Mitrovicë, përveç regjistrimit të këtyre lokacioneve dhe ndonjë iniciative/investimi të vogël, për më shumë se 10 vite nuk ka iniciuar ndonjë projekt të rëndësishëm në gërmimin, konservimin dhe restaurimin e këtyre vendeve arkeologjike në këtë regjion.

Zhvillimi i turizmit kulturor, rural, politik dhe industrial

Planifikimi dhe zhvillimi i turizmit në Kosovë, zyrtarisht ka filluar në Jugosllavi, me formimin e Asociacionit për Turizëm në Kosovë. Ky asociacion u formua më 1953 me idenë

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

për zhvillimin dhe promovimin e turizmit në Kosovë. Në programin e tyre promovues ata e quajten pjesën veriore të Kosovës si lugina e Ibrit. Kjo luginë është parë si potencial për turizmin kulturor dhe rural. Më vonë, pas luftës më 1999, UNMIK-u dhe institucionet e Kosovës e përpiluan një raport ku ata e quajten këtë pjesë si regjioni turistik i Kopaonikut, me deklaratën se këtu ka potencial për turizëm transit, turizëm ndërmarrësor dhe turizëm rural në Kopaonik dhe Mokra Gorë. Së fundmi në Mitrovicë, u inicuan disa iniciativa nga organizatat lokale si Mitrovica Guide që promovoi potencialin e turizmit në regjionin e Mitrovicës. Sot, shumë vizitorë vijnë nga jashtë në Mitrovicë vetëm për arsye të rritjes së njohurive mbi raportet ndëretnike, post-konfliktit e veçanërisht për vizitimin e urës në Mitrovicë. Gjatë verës, këtu vijnë me mijëra njerëz nga diaspora, të cilët sjellin shoqërinë e tyre në Kosovë, por ofertat dhe shërbimet për ata mungojnë. Kërkesa për turizëm është ngritur nga njerëzit lokal dhe këtu janë organizuar iniciativa lokale për udhëtime me biçikleta, parashutizëm dhe hiking por ato nuk janë materializuar dhe komercializuar sa duhet. Përveç Shalës së Bajgorës, pjesa e maleve që mund të shërbejë për turizmin rural (skijimi, aventurat e lehta dhe vendet arkeologjike) në Mitrovicë është edhe lugina e restauranteve për peshq, që e ka të zhvilluar turizmin dhe gastronominë vendore. Mitrovica dhe regjioni kanë potencial të mjaftueshëm për zhvillimin e turizmit kulturor dhe shërbejnë si transit për në jug për malet e Dukagjinit (Alpet shqiptare) nëpërmjet rrugës Mitrovicë-Pejë, ose bregdetit nëpërmjet magjistrales Drenas-Prishtinë-Prizren-Durrës.

Në drejtimin verior të Mitrovicës është transiti për qendrën e skijimit në Kopaonik dhe Beograd. Në këtë drejtim nuk janë bërë hulumtime rreth potencialit të turizmit në regjionin e Mitrovicës dhe institucionet lokale nuk kanë ende politikë të qartë sa i përket trajtimit e zhvillimit të sektorit të turizmit.

Kërcënimet

Zvogëlimi i vazhdueshëm i fondeve për sektorin kulturor dhe tërheqja e donatorëve ndërkombëtarë

Sipas operatorëve kulturor në Mitrovicën e Jugut, në Mitrovicë kemi zvogëlim të vazhdueshëm të fondeve që kanë përkrahur projektet dhe iniciativat kulturore të tyre. Kështu që ky fenomen është konsideruar si kërcënim pasi që mbyllë mundësitë për këto organizata kulturore ti zhvillojnë projektet që janë me përfitim për grupet të ndryshme, dhe në anën tjetër ndalja e këtyre iniciativave kulturore është barrierë që ndal funksionalizimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të sektorit kulturor.

Situata politike (konflikti ndër-etnik)

Konflikti ndër-etnik (veçanërisht ai mes shqiptarëve Kosovar dhe serbëve Kosovar) është konsideruar si kërcënim për funksionalitetin të sektorit kulturor, që në mënyrë konstante vendos zbrazëtira në aktivitetet e ndryshme kulturore dhe mbyllë mundësitë të cilat e inkurajojnë dhe lejojnë bashkëveprimin dhe komunikimin ndër-etnik.

Migrimi i vazhdueshëm i artistëve dhe i të rinjve me potencial

Migrimi i vazhdueshëm i të rinjve tashmë është fenomen që kërcënon funksionalitetin potencial të sektorit kulturor, duke e bërë të vështirë të gjenden njerëz adekuat për aktivitetet e ndryshme kulturore. Sipas të dhënave nga fokus grupi arsyet e migrimit të këtyre artistëve janë për shkak të mungesës së mundësive në Mitrovicë, që vjen deri te vështirësitë financiare për të ushtruar profesionet artistiko/kulturore.

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Privatizimi i infrastrukturës kulturore

Është konsideruar si kërcënim, që nga privatizimi i infrastrukturës kulturore; janë rindërtuar dhe përdorur për qëllime të ndryshme, këto shkatërrojnë funksionalitetin e sektorit kulturor, duke zvogëluar vendet dhe hapësirat për veprim/prodhim.

Degradimi i monumenteve të mbrojtura si pjesë e trashëgimisë së paluahatshme kulturore

Është parë si kërcënim përderisa në Komunën e Mitrovicës kemi mungesë së strategjisë së qartë për mbrojtjen e trashëgimisë së paluajtshme kulturore. Disa nga ndërtesat që janë në listën për mbrojtje janë dëmtuar dhe shkatërruar në vijimësi, rasti i hamamit të vjetër të qytetit dhe shtëpia e Xhafer Devës, si dhe objekte tjera me rëndësi siç ishin dy ndërtesat e vjetra të cilat janë përdorur për kinema në qytet dhe gati e gjithë qytetëza (me kinemanë) në Stan Tërg, monumenti dy-dimensional i dedikuar minatorëve, i cili qe hequr pa ndonjë vendim juridik apo pëlqim publik. E gjithë kjo rezulton si pasojë e mos definimit të qartë, se cili është roli i institucioneve lokale si DKRS-së dhe Qendrës Rajonale për Mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

PEST Analiza

Politike/Legale. Sipas Jobber 2010, forcat politike dhe legale mund të kenë influencë në vendimmarrje duke vendosur rregulla me të cilin sektori mund të kontrollohet. Ka ndikim të njëjtë brenda sektorit civil; Kosova konsiderohet si vend ndëretnik, dhe njëri prej qyteteve i cili është ndikuar negativisht më së shumti nga konflikti Kosovaro/Serb është Mitrovica; qytet i ndarë në dy pjesë, pjesa Shqiptare dhe pjesa Serbe. Kjo situatë politike ka pasur ndikim gati në çdo sektor në Mitrovicë, duke përfshirë edhe kulturën, e cila është një prej sektorëve që ka nevojë për bashkëpunim ndëretnik. Sipas “Kultura për të gjithë” diversiteti kulturor është identifikuar si një prej resurseve që Kosova posedon, duke përfshirë këtu Mitrovicën, njëri prej

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

regjioneve me më së shumti lloj-llojshmëri në Kosovë, i cili mund të ndihmojë në lehtësimin e konfliktit të shoqërisë së rënduar. (Kultura për të gjithë, 2010-2012)

Sipas institucioneve kulturore në Mitrovicë, një tjetër pengesë që ndalon zhvillimin e sektorit kulturor janë ligjet që kanë të bëjnë me kulturë, ku sipas “forumit kulturor” struktura legale duket të jetë njëri ndër problemet më të mëdha të sektorit kulturor, jo pse këtu mungojnë rregullat ligjvënëse por sepse ato janë të jo-strukturuara dhe joadekuate. (Forumi Kulturor, 2014)

Po ashtu konsiderohet që ligjet, rregulloret dhe instruksionet administrative në sektorin kulturor, shpesh shkaktojnë stagnim në zhvillimin e këtij sektori, përderisa në disa raste ato e dëmtojnë këtë proces. Në anën tjetër problem tjetër i rëndësishëm konsiderohet të jetë procesi i implementimit të ligjeve që rregullojnë sektorin kulturor. (Forumi Kulturor, 2014)

Nepotizmi dhe politizimi –punësimi i njerëzve joadekuat/jo-profesional: këto praktika janë shumë të popullarizuara në çdo institucion në Kosovë dhe ky fenomen tashmë është pjesë e bisedave të përditshme. Sipas operatorëve kulturor të Mitrovicës ky fenomen ka ndikuar në mënyrë negative në funksionalitetin dhe zhvillimin e sektorit kulturor përgjatë 17 viteve të fundit.

Ekonomike. Mjedisi ekonomik ka ndikim kyç në sukses nëpërmjet ndikimit të tij në ofertë dhe kërkesë. (Jobber 2010) Në lidhje me rastin e sektorit kulturor, mund të thuhet që punësimi është njëri prej problemeve kryesore që komuna e Mitrovicës ballafaqohet dhe që njëherit ka ndikim të lartë në aktivitetet e institucioneve të varura e të pavarura kulturore.

Sipas z. Miran Salihu- Drejtori i qendrës për mirëqenie sociale në Mitrovicë, Mitrovica mbetet qyteti me papunësinë më të lartë (Bota sot, 2016). Bazuar në të dhënat nga debati “Politika dhe Kultura në Mitrovicë” besohet që shkaku i pjesëmarrjes së ulët dhe mungesës së

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

përkrahësve të aktiviteteve kulturore të organizuara nga sektori kulturor në Mitrovicën e Jugut, është po ashtu shkalla e lartë e papunësisë, e cila shkakton dekurajim emocional tek të qenit pjesë e aktiviteteve kulturore. Në anën tjetër faktori ekonomik ndikon drejtpërdrejt në zhvillimin e sektorit kulturor në Mitrovicë, ku vetëm 0.36% e buxhetit total është e ndarë për sektorin kulturor në Kosovë. (Forumi Kulturor, 2014) Gjersa në Mitrovicën e Jugut vetëm 13.75% (75,392.00 EUR) prej buxhetit total të DKRS shkon për subvencione, vetëm 13.26% (10,000 EUR) prej buxhetit total prej subvencioneve është e ndarë për entitetet jopublike (kultura, sporti dhe OJQ-të e të rinjve). (DKRS Plani i buxhetit vjetor 2016-2018)

Sociale / Kulturore. Ky element i PEST analizës është shumë i rëndësishëm sidomos tek operimi i operatorëve kulturorë. Sipas Institutit GAP popullata e Mitrovicës përbëhet nga përafërsisht 72.000 banorë ku shumica e tyre janë shqiptarë e përcjellë nga minoritetet si serbët, boshnjakët, romët, egjiptianët, turk dhe komuniteti goran. Përfshirja e këtyre komuniteteve ka influencë pozitive dhe negative për operatorët kulturor, gjatë implementimit të aktiviteteve të tyre. Ana pozitive është se kjo i mundëson operatorëve kulturorë të përfshijnë të gjithë komunitetet në aktivitetet e tyre dhe të stimulojnë bashkëveprimin ndëretnik, ndërsa ndikimi negativ është se për arsye politike operatorët kulturorë në Mitrovicë hasin në vështirësi përderisa tentojnë të implementojnë aktivitete të llojllojshme, më së shumti aty ku shqiptarët kosovarë dhe serbët kosovarë kërkohen të përfshihen së bashku, edhe pse sipas “Kulturës për të gjithë” diversiteti kulturor ka qenë i njohur në dekadën e fundit nëpërmjet rregullave dhe iniciativave të BE-së, Këshillit të Evropës dhe UNESCO, si njëra prej përparësive kryesore të Kosovës. (Kultura për të gjithë, 2010-2012)

Teknologjike. Avancimi i teknologjisë e bënë të lehtë bashkëpunimin ndërmjet organizatave, qasjes te audienca dhe konsumatorët, dhe veprimtarive të përditshme. Sipas intervistave dhe

fokus grupeve, përdorimi i video kamerave të reja dhe pajisjeve , sistemit të ri të pagesave (E-banking), dhe internetit në përgjithësi është duke i mundësuar operatorëve kulturorë t'i shpallin aktivitetet e tyre dhe planet për audiencën e synuar në mënyrë më të shpejtë dhe me çmim më të ulët. Kjo mundëson partneritetin, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin mes tyre. Për më shumë, sipas të dhënave nga fokus grupet, shumë prej operatorëve përdorin rrjetet sociale si (facebook, twitter, instagram etj) që t'i promovojnë aktivitetet e tyre, për rekrutim dhe iniciativa të tjera të cilat janë pa pagesë. Kështu që në përgjithësi avancimi i teknologjisë kontribuon pozitivisht në zhvillimin e operatorëve kulturor në shumë mënyra.

Diskutimi i të gjeturave

Metoda të shumta analitike janë përdorur për të iu adresuar pyetjes kryesore të prezantuar në hyrje. Edhe pse informata të jashtëm nga organizata apo programe ndërkombëtare kanë pasur një rol mbështetës në këtë hulumtim, të dhënat më domethënëse u nxorën nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta me katër grupet e tona primare. Metoda e përzier konvergjente na e mundësoi krahasimin e të gjeturave tona dhe analizën e studimeve të jashtme.

Gjatë këtij hulumtimi ishte e gjithëpranishme edhe baza e zhvillimit të qëndrueshëm dhe shtyllave relevante, në të cilat UNESCO kishte shtuar edhe një shtyllë të katërt, të mundshme. Një numër i studimeve janë përpjekur me vendosmëri të kyçin kulturën me zhvillimin ekonomik - veçanërisht në vendet në zhvillim - dhe qëndrueshmëri. Kjo teori informoi qasjen tonë në statusin kulturor të Mitrovicës dhe atë nëse kultura ka potencial për zhvillimin ekonomik të komunitetit. Po ashtu ka shërbyer si përkujtues për fokusimin në përfaqësimin e kulturës – burimin më të madh të përgjigjeve tona. Ky dokument gjerësisht pajtohet me qëndrimin e UNESCO-s sa i përket kontributit të industrisë kreative në performancën e zhvillimit ekonomik.

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Përveç përparësive që kultura mund të shtojë për ekonominë e Mitrovicës Jugore, të gjeturat tona tregojnë që përfaqësuesit e institucioneve publike nuk i japin rëndësi të mjaftueshme kësaj çështjeje.

Rishikimi i raporteve të buxhetit vjetor të DKRS na dha një formë të matjes për nivelin e rëndësisë që qeverisja lokale i jep sektorit kulturor. Dokumentet financiare zbulojnë sasi relativisht të vogël të interesit, po ashtu disproporcion në ndarjen e rrogave krahasuar me linjat tjera të buxhetit. Vlera e fondeve e paraparë për subvencione, e cila mbështet aktivitetet kulturore, ka ndihmuar të qartësohet pozita e sektorit kulturor brenda prioriteteve komunale.

Analiza SWOT, është po ashtu pjesë e këtij studimi që doli si rezultat i dy debateve dhe fokus grupeve të organizuara. Grupi i parë përfshiu përfaqësues të institucioneve kulturore, përderisa grupi i dytë përfshiu artistë të pavarur, profesorë të artit dhe qytetarë. Të dhënat nga dy grupet u regjistruan dhe u analizuan për të krijuar një narrativ të kompletuar, i cili solli tre (3) përparësi, nëntë (9) dobësi, shtatë (7) mundësi, dhe pesë (5) rreziqe.

PEST analiza (Politike-Ekonomike-Sociale-Teknologjike) analizoi indikatorët e jashtëm që ndikojnë në operimin dhe zhvillimin e kulturës lokale. Nga kjo analizë u gjet se teknologjia është faktori i cili ndikon pozitivisht në rrjetëzimin përmes mediave sociale, reduktimin e kostos, dhe përpjekjeve për promocion. Komponenti social gjithashtu ka përfitim për sektorin kulturor, pasi që rritë mundësitë për zgjerimin e bashkëveprimit në një mjedis ndëretnik.

Përmbyllja

Gjatë rrjedhës së këtij studimi, pyetja jonë fillestare na ekspozoi te një numri i pikave të interesit dhe rrugë për të gjetur përgjigje. Pyetja hulumtuese ishte strukturuar që të sigurojë të dhëna kualitative të rregullta dhe të besueshme nga grupet e synuara. Një shumicë e mjeteve të kërkimit ndihmoi grumbullimin dhe sinkronizimin perspektivat e ndryshme në mes të grupeve të synuara, për të arritur tek konkluzioni.

Në fakt, disa opinione janë regjistruar në çështjen e propozimit për Strategjinë Kulturore: ku institucionet dhe operatorët në mënyrë universale u shprehën në intervista, debate, dhe fokus grupe, dhe rreth 66% të qytetarëve ndanë vlerësim të njëjtë. Megjithatë, vetëdijesimi për dëmin që shkakton mungesa e një plani të tillë strategjik është e ndarë ndërmjet katër grupeve të synuara.

Kultura mundëson vlerë të vërtetë tek zhvillimi ekonomik. Ky konkluzion gjen përkrahje jo vetëm nga diskutimi mëhershëm i kampanjës së UNESCO-s, por edhe nga rastet relevante të studimit, si Dokufesti në Prizren. Megjithatë, situata aktuale në Mitrovicë shfaq një model të përkrahjes jo të mjaftueshme politike, jo-koordinimit të operatorëve, operimit nën-optimal. Mungesa e një strategjie zyrtare për kulture në Mitrovicën e Jugut është edhe pasojë edhe mundësues i sfidave të shënuara në këtë sektor.

Rekomandimet

“Zhvillimi i strategjisë zyrtare -gjithëpërfshirëse për kulturë”

Sipas analizës së këtij projekti hulumtues, arsyeja e keq-funksionimit dhe jo-organizimit të sektorit kulturor në Mitrovicë është mungesa e strategjisë zyrtare-gjithëpërfshirëse kulturore. Me zhvillimin e kësaj strategjie, sektori kulturor do të kishte një agjendë dhe përfaqësues adekuat, të cilët do të kujdeseshin për programin dhe rrjedhën kulturore.

Nën-Rekomandimet

“Rritja e buxhetit komunal për sektorin kulturor”

Bazuar në analizën tonë buxheti vjetor aktual për kulturë është rreth 25,000 Euro, që sipas operatorëve kulturor dhe institucioneve nuk mjafton për zhvillimin e duhur të sektorit kulturor. Shumë ide të vlefshme dhe projekt propozime të cilat do të kontribuonin në sektorin kulturor në Mitrovicë janë lënë pa u implementuar për shkak të buxhetit të ulët. Me rritjen e buxhetit shumë ide dhe projekt propozime inovative, kreative dhe me vlerë do të kishin mundësinë të implementohen dhe sektori kulturor do të ishte më i pasur si për nga sasia ashtu edhe nga cilësia e aktiviteteve.

“Të shtohen prioritetet/avantazhe për kuadrot në deficit nga fushat kulturore në programin komunal të bursave”

Sipas hulumtimeve primare dhe sekondare të aplikuara në këtë analizë, programi për bursa i Mitrovicës nuk ka ndonjë kriter për kuadrot me deficiencë duke përfshirë edhe të fushës kulturore. Zhvillimi i kapaciteteve profesionale në fushën kulturore është nevojë e rëndësishme;

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

me dhënien e prioriteteve/avantazheve për këto kuadro me deficit nga programi i komunës për bursa, do ti shtyjme/stimulojmë studentët nga Mitrovica të aplikojnë dhe të studiojnë në profesionet që kanë të bëjnë me kulturë, dhe që pas kësaj të kontribuojnë me marrëdhënie kontraktuale në sektorin kulturor të qytetit të tyre.

“Projekti hulumtues mbi potencialin e zhvillimit të turizmit në regjionin e Mitrovicës”

Në kohën e Jugosllavisë, ishin institucionet lokale të cilat kujdeseshin dhe përcjellnin numrin e vizitorëve/turistëve në Mitrovicë. Lidhja e Mitrovicës me malet e Kopaonikut dhe vendet e tjera të Kosovës, bënë Mitrovicën qytet potencial për turizmin transit. Sot, pas ndarjes së qytetit në dy (2) komuna, potenciali për turizëm politik apo edukativ është rritur. Në anën tjetër, resurset natyrore dhe pamjet e bukura të regjionit të Shalës, janë potencial për zhvillimin e turizmit rural/kulturor i cili do të lidhej edhe me turizmin industrial, gjithashtu. Andaj është shfaqur nevoja të fillohet me një projekt hulumtues në mënyrë që të dihet situata e tanishme dhe potenciali i vendeve, infrastrukturës, resurseve humane dhe shërbimeve të turizmit në këtë zonë/regjion.

“Inicimi i projekteve për gërmime arkeologjike në Regjionin e Shalës”

Regjioni i Mitrovicës është i njohur si zonë e pasur arkeologjike duke marrë për bazë të gjeturat arkeologjike që datojnë 7000 vite të vjetra. Vendet e famshme arkeologjike në këtë regjion janë Fafosi, Zhitkovci, dhe Vallaci që vërtetojnë ekzistencën para-historike të civilizimit e njohur si kultura e Stracevas dhe Vincas. Shumë artefakte janë gjetur në regjionin e Shalës dhe s’ka pasur interes nga institucionet nacionale relevante të iniciojnë projekte për hulumtime arkeologjike. Zonat e reja arkeologjike e me potencial turistik, do ti rrisnin bizneset e vogla

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

familjare në zonat rurale, do të rritnin numrin e vizitorëve dhe do ta ndryshonin perceptimin negativ për këtë regjion.

“Projekti hulumtues mbi vizibilitetin e zonave të pa-përdorura industriale”

Duke pasur parasysh që Mitrovicës i mungon infrastruktura kulturore dhe është treguar si problem i madh për komunën, Mitrovica e njohur më parë si një qytet industrial ka një numër të madh të ndërtesave dhe fabrikave të braktisura të cilat në bazë të disa shembujve nga shtetet e BE-së, do mund të ri-aktivizoheshin për nevoja të komunitetit të artistëve si dhe industrisë kreative, andaj është vënë re nevoja për të përgatitur një projekt hulumtues mbi potencialin e përdorimit të këtyre zonave dhe ndërtesave të braktisura.

Referencat

Munasinghe, Mohan. "Addressing Sustainable Development and Climate Change Together Using Sustainomics." WIREs Clim Change Wiley Interdisciplinary Reviews: Climate Change 2.1 (2010): 7-18. Web. 04 Dec. 2015.

Christensen, Ronald, Wesley Johnson, Adam Branscum, and Timothy E. Hanson. Bayesian Ideas and Data Analysis: An Introduction for Scientists and Statisticians. Boca Raton: CRC, 2010. Web. 05 Jan. 2016.

"Ministria Dhe Komunitet Përplasen Për Politika Kulturore - Kultura - Zeri." Zeri. N.p., n.d. Web. 13 Jan. 2016.

"Univ.-Prof. Dr. Wilhelm Fischer." Österreichische Musikzeitschrift 13.3 (1958): n. pag. Web. 20 Jan. 2016.

N., Jp - Eu/coe Support To The, and Promotion Of Cultural Diversity (Pc. MBI TRASHËGIMINË DHE DIVERSITETIN (n.d.): n. pag. Web. 25 Jan. 2016.

"A E Ndhimojnë Ekonominë Paratë E Diasporës? Efekti I Kontributeve Nga Remitancat." Kosovo 2.0 -. N.p., n.d. Web. 25 Jan. 2016.

(Prishtinë, Kosovë) Niqi", Fotografitë: Arben Llapashtica, Schweizerische Eidgenossenschaft, and Con. "Kosovo Human Development Report." (n.d.): n. pag. 2014. Web. 26 Jan. 2016.

Create UK, and Creative Industries Council. Creative Industries Strategy (n.d.): n. pag. Web. 28 Jan. 2016.

Department for Culture, Media & Sports UK. "Creative Industries and Economic Development." Creative Industries and Economic Evolution (n.d.): n. pag. 14 Jan. 2014. Web. 28 Jan. 2016.

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Isar, Yudhishtir Raj. *Creative Economy Report 2013: Widening Local Development Pathways*. New York: UNESCO & UNDP, 2013. Web. 01 Feb. 2013.

Kosovo Initiative, For Stability. "Policy Analysis." *Mitrovica: One City, Two Realities* (n.d.): n.pag. 17 Dec. 2009. Web. 02 Feb. 2016.

United Nations Assembly. "65/166. *Culture and Development*". (n.d):n.pag. 28 Feb. 2011.

B.Torggles, R.Murphy, C.France, and J.B.Portoles "Evaluation Section *UNESCO's Work on Culture and Sustainable Development Evaluation of a Policy Theme*" (n.d): n.pag. Nov. 2015.

J. Serageldin, J.M.Brown. World Bank. "*Culture in Sustainable Development: Investing in Cultural and Natural Endowments*" (n.d):n.pag. 28-29 Sep. 1996

A. Hooper. Australian National University. "*Culture and Sustainable Development in the Pacific*" ANU E Press & Asia Pacific Press: n.pag. 2005

A. Bhattacharya. "*The Role of ICH NGOs: Integrating Culture in Planning and Action for Sustainable Development*" (n.d):n.pag. 2014.

UNDP/UNESCO. "*Creative Economy Report: Widening Local Development Pathways*". (n.d): n.pag. 2013.

Culture 21. "*United Cities and Local Governments – Committee on Culture: Agenda 21 for Culture*". (n.d): n.pag. 8 May. 2004

F. Bertrand, S. Brault, M. Cote, R. Derouin, S. Drouin, J. Fortin, V. Guevremont, . Mayrand, G. Moisan, C. Paire, L. Sicuro, A. Vcillarcourt. Agenda 21 C. "*Culture Today and Tomorrow*". Imprimerie L'Empeinte: n.pag. 2012

ANALIZË E SEKTORIT KULTUROR NË MITROVICË

Agenda 21 for Culture. “*An undertaking by cities and local governments for cultural development*” (n.d): n.pag. Barcelona, 2004.

UNGA – 68th session. “*Thematic Debate: Culture and Sustainable Development in the Post-2015 Development Agenda*” (n.d): n.pag. 2014.

Bianchini, Franco. “*Reflections on urban cultural policies: The development of citizenship and the setting of minimum local cultural standards and entitlements*”. (n.d): n.pag. 2006.

Holden, John. “*Cultural value and the crisis of legitimacy: Why culture needs a democratic mandate*”. Demos. 29 Nov. 2006

J.Pascual. “Cultural Policies, human Development and Institutional Innovations: Why we need and Agenda 21 for Culture” UNESCO observatory: n.pag. 2008

Forumi Kulturor. “*Raporti i Fokus Grupit: Kultura në politikat shtetërore të Kosovës*”. (n.d): n.pag. Maj. 2014

Forumi Kulturor. “*Raporti i Fokus Grupit: Buxheti shtetëror për Kulturën*”. (n.d): n.pag. Qershor. 2014

Forumi Kulturor. “*Raporti i Debatit: Kultura në Komunitet e Kosovës*”. (n.d): n.pag. Tetor. 2014

Forumi Kulturor. “*Analizë e shkurtër: Kultura në Kosovë – Specia që duhet shpëtuar*”. (n.d): n.pag. Nëntor. 2014

Culture for all. “*Creative Industries assessment report in Kosovo*”. (n.d): n.pag. 2010-2012

Bashkë-financuar nga: